

Duke filluar nga data 1 Korrik 2006, Shqipëria ka marrë Presidencën e rradhës së Rrjetit të Shëndetësisë së Europës Juglindore, për një periudhë 6 mujore, deri më 31 Dhjetor 2006.

Rrjeti i Shëndetësisë së Europës juglindore është krijuar në 2001, me nënshkrimin nga Ministri i Shëndetësisë së rajonit, në Dubrovnik, të Deklaratës së Dubrovnikut, ku vendet e rajonit angazhohen në nivelin më të lartë politik të bashkëpunimit në 7 fusha prioritare të shëndetit publik si shëndeti mendor, duhani, ushqimi, gjaku dhe nënproduktet e tij, urgjencat mjekësore, sistemet e informacionit shëndetësor, dhe semundjet infektive. Shqipëria ka kryesimin e projektit rajonal të Kontrollit të Semundjeve Infektive.

Në nëntor 2005, Ministri i Shëndetësisë dhe Financave të vendeve të rajonit u takuan në Shkup, ku rikonfirmuan angazhimin e vendeve respektive për bashkëpunimin rajonal në sektoret prioritare të shëndetit publik, si dhe theksuan rëndësinë e investimit në sektorin e shëndetësisë, si dhe transferimin e pronesisë së bashkëpunimit nga Europa në rajon. Po në këtë takim u miratua dhe Statuti i ri i Rrjetit ku specifikohet se Presidencën e këtij Rrjeti kalon me rotacion në çdo 6 muaj nga një vend tek tjetri sipas rendit alfabetik.

Rrjeti i Shëndetësisë së Europës Juglindore do të mbajë mbledhjen e tij Rajonale të rradhës në Tiranë në fund të nëntorit 2006 për të diskutuar dhe miratuar politikën rajonale lëshuar me Përgatitjen për Pandemite dhe ato të Shëndetit Mendor, vendosur pas konsultimeve me OBSH dhe KE.

Marrja e Presidencës së Rrjetit të Shëndetësisë së Europës Juglindore nga Shqipëria është shprehje e vullnetit të mirë të Shqipërisë për të luajtur një rol gjithnjë dhe më të rëndësishëm në bashkëpunimin rajonal, duke kontribuar në afrimin gjithnjë e më shumë të gjithë rajonit në BE.

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi të kontaktoni me Odeta Halili, zedhenese e shtypit të Ministrisë së Shëndetësisë, tel 04 376 275.